V E N D I M
Nr. 62, datë 7.3.2002

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË VILËS 30

(Ndryshuar me VKM nr. 254, datë 13.6.2002)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 14 e 15 shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. *Institutit të Trajnimit të Administratës Publike dhe Komisionit të Shërbimit Civil t'u jepet në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, vila 30, me të gjithë territorin përreth. Instituti dhe Komisioni nuk kanë të drejtë t'ua japin mjediset e kësaj vile në përdorim, pa shpërblim apo me qira, të tretëve.*

2. *Ngarkohen Instituti i Trajnimit të Administratës Publike dhe Komisioni i Shërbimit Civil të përballojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e pronës së dhënë në përdorim.*

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare t'i bëjë dorëzimet përkatëse të kësaj prone të paluajtshme Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.

4. Pika 5 e kreut I "Për rrethin e Tiranës" të listës nr.1 të vendimit nr.34, datë 7.1.1999 të Këshillit të Ministrave "Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajnimin e personaliteteve të larta" shfuqizohet.

4. Ngarkohet Instituti i Trajnimit të Administratës Publike të vërë në dispozicion të Komisionit të Shërbimit Civil pjesën e mjediseve, sipas skemës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

(Shtuar me VKM nr. 254, date 13.6.2002)






VILA 30